



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01 Nr. 12/02-12973
Datë: 15.08.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 6 pika 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2020 Kujdesi Parësor Shëndetësor, duke vendosur lidhur me formimin e grupit punues për hartimin e draft Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, me datë 15.08.2024 merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet grupi punues për hartimin e draft Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, në këtë përbërje:
 1. Adelina Shehu - Kole, Kryesuese
 2. Kushtrim Brahimaj, anëtar
 3. Arben Koshi, anëtar
 4. Leonora Bakija, anëtare
 5. Frrok Gjergjaj, anëtar
2. Grupi i përshkruar si në pikën 1 të këtij vendimi, ka për detyrë dhe përgjegjësi, që në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të përgatitë draft Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Grupit Punues
- Arkivit

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës